



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 14545 Prot.

Fier, më 22.12.2025

Projekt - Vendim

Nr. 117 dt. 22.12.2025

“Për një saktësim në Vendimin nr. 53 dt. 30.04.2024 të Këshillit Bashkiak Fier “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve Led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre””.

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .12.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, ligji nr. 9632 dt. 30.10.2006 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”, i ndryshuar, VKM 408/2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” i ndryshuar, Vendim i Këshillit Bashkiak Fier nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”, VKB nr. 53 dt. 30.04.2024 të Këshillit Bashkiak Fier “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve Led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre” **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

1. Saktësim e pikës 3 të Vendimit nr. 53 dt. 30.04.2024 të Këshillit Bashkiak Fier “Për miratimin në parim për vendosjen e ekraneve Led në hapësirë publike nga subjektet që ushtrojnë aktivitetet reklamues ose që synojnë të reklamojnë biznesin e tyre” si vijon:
 - “Tabelat e ekraneve Led që do të vendosen në hapësirat publike sipas përcaktimeve të pikës 1 të VKB nr. 53 dt. 30.04.2024 do të jenë në përmasa deri në 35 m² si dhe niveli i bazës së taksës, do të jetë në përputhje me përcaktimet e aneksit 7 pika III e tabelës sipas V.K.B nr. 131 dt. 26.11.2024 “Mbi strukturën dhe nivelin e taksave dhe tarifave vendore të vitit 2025”
 - Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Menaxhimit të Pronave dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore”.

Konc. M. Petushi

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Drejtori: F. Troka

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

A. Abazi

Drejtoria Juridike

Drejtore – E. Kapllanaj

KRYETARI
Armando SUBASHI

